



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDERMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më .04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: objekt **“Blerje sherbime riparimi per mjetet motorrike të Ndërmarrjes”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50112000-3 – Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash;

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 994 733.33 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi të së cilëve është 5,287,533.33** (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Fier (njesia e prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licence, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, për ushtrimin e veprimtarisë servis automatësh.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të

paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e Thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat"* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per këtë pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtem:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 3 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **8 (tetë) punonjës** për **muajin Mars 2026**. Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues.

Shënim: Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës **nr.10**.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.2**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Mars 2026**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Mars 2026**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Mars 2026** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim.

Gjykohet se **8 punonjës** janë të mjaftueshëm për realizimin me sukses të shërbimit, objekt kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Drejtues Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë në listepagesën e shoqërisë për muajin Gusht 2025 dhe të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).*

Shënim: Për pikën **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, me sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt I kontratës të leshuara nga autoritetet kompetente; *si dhe operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter bazohet gjithashtu në Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to”.*

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

Operatorët ekonomikë pjesmarres duhet të kenë të punësuar inxhinierë dhe specialiste të kualifikuar për realizimin me cilësi të shërbimeve të kërkuara, si më poshtë:

1. Inxhinier mekanik	1 (nje)
2. Punonjes mekanik	2 (dy)
3. Xhenerik	1 (nje)
4. Motorrist	1 (nje)
5. Elektroauto	1 (nje)
6. Saldator	1 (nje)
7. Pompist	1 (nje)

Operatorët ekonomikë pjesmarres duhet të paraqesin një listë të punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK më sipër.

a)- Per inxhinierin mekanik ose teknik, mekanik transporti duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune (e vlefshme),
- *Diplome universitare,*

b)-Per specialistet duhet të paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune (e vlefshme),
- *Dokument që të vertetojë kualifikimin sipas profilit të kërkuar (diplome ose certifikate profesionale ose deshmi kualifikimi, etj.)*

Shënim: Për pikat **a)** dhe **b)** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës **nr.10**.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a) dhe b)** të pikes **2.3.4**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ne baze të pikes 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat, natyrën, volumet e preventivit si dhe me numrin e automjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambjente, për përmbushjen e shërbimeve të kerkuara në përputhje me specifikimet teknike apo termat e referencës të dhëna në DST, si më poshtë:

- | | |
|---|-------------------------|
| a- Pajisje ngritëse me kapacitet min. 3 Ton | min. 1 (një) |
| b-Mjet transportues për transportin e mjeteve të rënda deri në servis pa pagesë
min 1 (një) (<i>pronësi ose me qera</i>) | |
| a- Trapano të ndryshme | min. 2 (dy). |
| b- Aparat saldimit | min. 1 (një) |
| c- Kompresor ajri | min 100 (njëqind) litra |

Shënim: Për pikën **2.3.5 a), b), c), d), e)**, si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 a), b), c), d), e)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumenta zyrtare që vërtetojnë se këto pajisje i ka në pronësi aktualisht (*dokumenta që vërtetojnë blerjen, faturat e blerjes*) **ose** të pasqyruara në bilancin e shoqërisë me zera të vecante **ose** i ka marrë me kontratë qeraje të vlefshme. Në rastin kur janë marrë me qira duhet të paraqitet kontrata e qiramarrjes e vlefshme deri në perfundimin e marrëveshjes kuader.

Per piken 2.3.5 b) OE duhet të paraqesë lejen e qarkullimit, kolaudimin, siguracionin, dhe kontratën e qerases nëse është me qera.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kerkuara në këto kërkesë për kualifikim,

bazohet edhe ne nevojën për mundësinë e sigurtë të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitet teknike që lidhen me gadishmerinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin e në kohe dhe në cilësi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ofertues duhet të ketë në pronësi **ose** me qira një objekt (*servis*) për realizimin e kontratës, të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit për realizimin e kontratës, dhe të kete territor të mjaftueshëm për parkimin e mjeteve për kohën që është e nevojshme. Në rastin e ndodhjes së servisit jashtë territorit të Bashkisë Fier, operatori ekonomik do të marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje të automjeteve që kanë nevojë për shërbime.

Shënim: Për pikën **2.3.6** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.6** duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këto operatori duhet të paraqesë: foto të objektit (*servisit*) ku të pasqyrohen ambjentet e brendshme, repartet, ambjentet e jashtme, etj., si dhe dokumentin e pronësive për servisin (*shoqëruar me hartën treguese hipotekore*) ose kontratën noteriale të qirase me afat deri në përfundim të marrëveshjes kuader për objektin që prokurrohet

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që përpara vlerësimit të ofertave, të verifikojë në vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe të gjitha ambjentet e servisit të sipërcituara, me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të kërkuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”. Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtarie që lidhen me to dhe në Udhezimin nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur

kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se të gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, që do të përdoren për mirembajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë origjinale, të reja dhe prodhim sipas standarteve të CE **ose ekuivalente me te**, dhe se operatori ekonomik merr persiper garancinë e pjesëve të këmbimit për jo më pak se 1 (një) vit, nga data e montimit ose vendosjes, në përputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Pjesët e këmbimit të certifikuar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Me anë të kësaj deklarate synohet që pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 12 (dymbëdhjetë) muaj garanci.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me ane të se ciles garanton se pjesët e këmbimit që do të përdoren për objekt prokurimi, do të merren nga kompani prodhuese/distributore të licencuara sipas standartit

-Certifikate ISO 9001 : 2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente të saj.

Shënim: Për piken e mesiperme operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mesiperme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK dhe Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj të prodhuesit,

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 44, pika 1 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera*

vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor; dhe në pikën 6 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku është e cituar: 6.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. date 20.03.2018, Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune shërbime” ; dhe Rekomandimit nr. 6732 prot. Date 21.10.2020 si edhe rekomandimeve të Sektorit të Koordinimit për procedura të meparshme të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor; si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën.

Paraqitja e certifikates **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj të prodhuesit (për OE i kualifikuar i pari)** vlerësohet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës pasi bëhet e mundur identifikimi i origjinës së mallrave objekt prokurimi, dhe garanton për cilësinë e pjesëve të kembimit që do të perdoren për mjetet objekt prokurimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Titullarit AK me Nr.111/3 Prot., date 13.02.2026 “Mbi ngritjen e grupit të Punës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike, kushteve të vecanta të kontratës, si dhe hartimin e kërkesave të vecanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik për zhvillimin e

procedures se prokurimit publik me objekt: “Blerje sherbime riparimi per mjetet motorrike të Ndërmarrjes”, i cili ka përgatitur specifikimet teknike dhe komisioni i testimit te tregut dhe përlllogaritjen e fondit limit i ngritur me Urdher te Titullarit AK me Nr.111/4 Prot., date 13.02.2026, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit, ne baze te materialit te ardhur me me nr.167 prot., dt. 25.02.2026 protokolluar ne Bashkine Fier me nr. 2583 prot., date 25.02.2026.

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit.

Njësia e prokurimit:
